

INTERVISTË ME NAIME MAÇASTENA SHERIFIN

Prishtinë | Data: 4 mars, 2022

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

- Naime Maçastena Sherifi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Naime, nëse mundeni me u prezantu me na tregu datën e lindjes, vendin edhe diçka për prejardhjen e ju, familjen e ju?

Naime Maçastena Sherifi: Unë jam Naime Maçastena Sherifi, jom e lindun më 27 shkurt 1968. Kam lindë në qytetin e Stambollit në Turqi. Në vitin 1973 ne jemi kthy me prindt e mi edhe me dy vllaznit e mi prej Turqisë, jemi vendosë në Prishtinë. Atëherë kam qenë katër vjeçe. Po ashtu prindt kanë qenë të deportuar në Turqi. Familja e nanës ka qenë në vitin 1912 të deportuar. Atje kanë lindë pastaj nana ime, të gjithë, tezet, dajtë. Kanë kriju familje atje dhe prej atëherë jetojnë në Turqi. Në 1956-ën osht' depërtu familja e babës tim se kanë qenë familje e përndjekur prej regjimit.

Tre axhallarë të babës tim kanë qenë të ekzekutum atëherë nga... me 2 dhjetor, 1945. Janë ekzekutu si pjesëmarrës të Ballit Kombëtar. Këta i kanë ekzekutu partizanët sa u kanë komunistat në mes kishës dhe xhamisë në qytetin e Ferizajit edhe familjes asniherë nuk ju kanë dhanë trupat e tyne. Ne nuk e kemi ditë. Familjartë kurrë s'kanë ditë ku janë vorrosë edhe ku gjinden eshnat e tyne. Pastaj 1956-ën në kohën e Rankoviqit kanë bo shumë presion edhe gjyshi im është detyru m'i marrë grunë edhe fëmijtë edhe me ikë për Turqi.

Atje janë vendosë me ni qytet që osht' në pjesën veri-lindore të Turqisë, Samsun thirret, ku ka qenë i vendosun edhe ni komunitet shumë i madh i shqiptarëve. Përndryshe, gjyshi im ka qenë imam dhe është vendosë në njërin, si imam xhamie në njërin prej fshatrave aty ku ka pasë... sepse zona e Samsonit edhe Bafra kanë qenë pothuajse pjesa ku ma së shumti ka pasë shqiptarë të vendosun në Turqi edhe ata të deportuar në vitin 1912. Kryesisht, në ato zonat i kanë dërgu nëpër zonat e armenëve ku kanë qenë. I kanë deportu armenët edhe i kanë vendosë shqiptartë e Kosovës kryesisht.

Pas një periudhe, normalisht që prindt e mi janë martu atje. Nana osht' e lindur në Turqi dhe pas shumë peripecive normalisht si familje emigrantësh, familje me probleme të vendosjes dhe integritit, këta në vitin 1964 ose '65 janë ardhë prej Samsonit janë vendosë në Stamboll, ku unë kom lindë. Kemi jetu atje edhe katër vite tjera domethonë edhe 1973-tën babi im definitivisht vendosë m'u kthy për Kosovë, sepse ai s'ka qenë asnjëherë i pajtimit me jetu atje.

Mas ndryshimeve që kanë ndodhë domethonë në Kosovë, mas ramjes së Rankoviqit edhe krijimit të ni frymës pak ma liberale... që ka qenë shumë e shkurtë edhe e përkohshme sepse pastaj në vite të '80-ta u pa që nuk osht' ashtu qysh edhe proklamohet. Baba im bindej, jo bindej, por kërkon m'u kthy këtu. Jemi vendosë te disa familjarë ni kohë. Pastaj kemi jetu në kushte goxha të vështira ekonomike për shkak se nuk pranoheshim prej shtetit. Nëntë vite ne s'kemi pasë fare shtetësi, domethonë kemi jetu me disa dokumente që kanë qenë për qëndrime të përkohshme. Vazhdimisht babën tem e kanë marrë në pyetje, "Pse je kthy? Duhesh m'u kthy prapë atje. Nuk duhesh me nejt këtu, këtu s'bon. Ju jeni familje nacionaliste, ju jeni kështu, jeni ashtu. Duheni me u kthy atje". Mirëpo, ai ka rezist, nuk ka pranë m'u kthy.

Ka qenë shumë i vendosun në idetë e tij, në idealin për me dashtë vendin. Qashtu u edukum në qat' frymë, në frymën e prindve të mi. Edhe normalisht që viti 1981 krijoi ni kthesë shumë të madhe. Ai mllëfi i akumulum i qytetarëve, i shqiptarëve në Kosovë edhe në ish-Jugosllavi në përgjithësi për padrejtësitë që boheshin. Në 1981-tën, normalisht që shpërtheu me ni demonstratë jashtëzakonisht të madhe masive e unë kom qenë shumë e re, domethonë diku rreth 14 vjeç kur kanë ndodhë këto. Dhe kam qenë pjesëmarrëse aktive në ato ditë të mëdha, 1 prill, 2 prill, 3 prill, që kanë ngjallë 1981-tën.

Të frymëzum prej ktyne lëvizjeve që ndodhshin edhe pakënaqësive që i shishim nëpër familjet tona në përgjithësi, prej atyne që dëgjojm, arrestimet e arsimtarëve, largimet nga puna, arrestimet e të afërmve. Ajo ndikoi edhe te gjenerata jonë si shumë të ri, atëherë 14-15 vjeç. Edhe ne me atë ideologjinë tonë, me atë dëshirën tonë për me kontribu e patëm kriju ni grup të rive që ishim krejtësisht 14-15 vjeçarë, 16 vjeçarë të cilët vazhdimisht i ndëgjonim këto biseda nëpër familjet tona, i dëgjonim këto rrëfime. Ajo dëshira jonë për me bo diçka me ndryshu, domethonë në këtë drejtim. Ndoshta pa qenë të vetëdijshëm në rrezikun në të cilin ne futeshim se ishim shumë të ri.

Edhe ky grup i joni që ishte e përbarë prej gjashtë-shtatë fëmive, në mesin e tyre kam qenë unë dhe kanë qenë edhe disa shokë të klasës, patëm organizu shkrumjen e parollave. Atëherë nëpër muret e shkollave, në qytet, shpërndarje të ndryshme të trakteve, materiale që ishin me ideologji propagandistike ashtu qysh i thojshin regjimi. Të ndalume për shtetin, për pushtetin me emërtimin që ishin kundër "vllaznim-bashkimit", irredentista, kështu, kështu. Po ne i shpërndanim nëpër qytet, nëpër moshatarë tonë materiale të ndryshme që kishin përmbajtje kombëtare. Edhe kështu punum na në ilegalitet deri në vitin, prej vitit '82, fundviti i '81 deri në '84. Domethonë, krynim shumë aktivitete të ndryshme. Po normalisht që...

Anita Susuri: Ju kur keni hy në ilegale, keni qenë shumë e re...

Naime Maçastena Sherifi: Shumë.

Anita Susuri: 14-15 vjeçare...

Naime Maçastena Sherifi: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë fillimi? Po më duket osht' punu në celula...

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. Ne kemi punu në grupe të vogla, domethonë ka qenë ni grup i madh edhe anëtarët e atij grupi secili i ka pasë celulat e veta, treshat e veta dhe... për shembull, ni grup temin prej tre vetave shoktë e mi nuk e kanë njoftë. Kështu kemi punu, në këtë sistem. Grupin e ni shokut tonë, për shembull treshen e tina unë nuk kom njoftë. Kjo ka qenë për shkak të rumjes së sekretit, në mënyrë që nëse bi, mos me ra të gjithë. A po kupton? Mos me pasë informata që në situata të caktume mos me i qit' njëri-tjetrin.

Ky ka qenë sistemi atëherë në cilin osht' punu edhe ka qenë ni sistem shumë interesant edhe që ka rezultu për mos me ra të tjetër në burg. Kur kemi ra na, për shembull shumë pak të tjerë kanë ra edhe pse kanë qenë aktivista, por nuk janë dekonspiru. Kjo ka qenë ni sistem mbrojtës që kemi pasë na për me mbrojtë njoni-tjetrin. Praktikisht, na me 20, diku në tetor të '84-tes unë jom arrestu, domethonë edhe atëherë jemi arrestu pothuajse i tonë grupi. Në mesin e tyre janë arrestu edhe dy shoqe tona që kemi pasë na lidhje me to. Normalisht që Sigurimi Shtetnor atëherë na kanë përcjellë. Na masandej kemi kuptu shumë gjana tjera të cilat edhe nuk i kemi ditë, se ka pasë njerëz të infiltrum mrena përmrena neve të cilët përmes tyre na kanë përcjellë edhe i kanë pa kontaktet tona.

Kur kemi ra na, ka ra edhe Teuta Bekteshi, [Teuta Hadri](#). Domethonë, si pasojë e asaj përcjellje, takimeve tona që i kishim na takimet e mshefta. Edhe janë intervistë shumë të ri, mirëpo në ato rrethana jemi arrestu vetëm unë edhe Bujar Zeneli, të cilin e kemi pasë shok grupi. Ai ka qenë kryesuesi të cilëve na kanë konsideru ma të randësishmit edhe sipas tyre, ma të rrëzikshmit domethonë. Vërtetë jemi malltretu shumë për moshën që kemi pasë. Edhe pse me të thanë të drejtën, unë gjithmonë e thom edhe atëherë Jugosllavia ka qenë nënshkruese e këtyne konventave, traktakteve ndërkombëtare për të drejta të njeriut, për mbrojtjen e të drejtave të fmive, mirëpo nuk i kanë përfillë domethonë.

Sidomos në procedurat e hetimit edhe në procedurat e marrjes në pyetje, për shembull krejt rregullat, krejt ligjet janë konë të shkeluna, sepse ata... ne si të mitur nuk kanë pasë të drejtë as me na rreh, as me na marrë në pyetje, as me na keqtrajtu psikikisht, as fizikisht. Osht' dashtë me qenë prezent ose prindi gjatë hetimeve ose kujdestari i caktum prej Qendrës për Punë Sociale. E njejta vlen edhe sot. Domethonë, osht' në rastet e të miturve delikuent, patjetër që policia nuk guxon ni të mitur me marrë në pyetje pa pasë ni punëtor social ose pa qenë prindi, ose pa qenë ni psikolog prezent. Domethonë, këto masa atëherë nuk janë përfillë te asnjëni prej rasteve të grupeve të miturve që i kanë arrestu për çashtje politike.

Normalisht që trajtimet kanë qenë jashtëzakonisht të këqija, domethonë hetimet kanë zgjatë diku katër-pesë muj edhe gjatë tanë kohës së hetimeve, sidomos muji parë ka qenë jashtëzakonisht i

vështirë për neve sepse jemi trajtu shumë keq. Unë jom majtë 72 orë në Prishtinë, në burgun e Prishtinës edhe pastaj jom dërgu në burgun e Mitrovicës që ka qenë një ndër burgjet ma të vështira në ish-Jugosllavi. Gjatë tanë kohës së hetimeve, derisa jemi dalë në gjygj jom mbajtë në Mitrovicë. Ndërkaq, Bujari osht' mbajtë në Prishtinë. Edhe burgu i Prishtinës pak ka pasë dallim prej atij të Mitrovicës. Kushtet kanë qenë jashtëzakonisht të kqija edhe trajtimi ka qenë shumë i keq.

Anita Susuri: Dashta m'u kthy ma herët para se të vazhdojmë te burgu. Po du me ju pytë pak ma shumë për ilegalen, këto traktet, këto...

Naime Maçastena Sherifi: Literaturën.

Anita Susuri: Parullat që janë shkru, çfare kanë qenë për shembull, çfarë parulla? Edhe qysh osht' organizu për m'i shkru?

Naime Maçastena Sherifi: Krejt, atëherë, ajo që osht' kërku ma së shumti prej neve ka qenë republika. Domethonë, ne atëherë krejt kemi qenë të koncentrum në krijimin e republikës së shtatë të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, sepse kjo ideja për me kriju shtetin atëherë ka qenë shumë larg. Domethonë, ne as që kemi... se nuk e kemi marrë me mend që munden me ndodhë ndyshime të tilla. Ndoshta, diku 20 e kusur vjet ma vonë edhe m'u kriju ni shtet me emrin Kosovë. Për neve kjo çka ka ndodhë tash osht' ni mrekulli në veti.

Ka qenë me kriju ni barabarësi të popullit shqiptarë në ish Jugosllavi. Ai me qenë i barabartë me të gjitha popujt tjerë që i kishin republikat e veta edhe e kishim ni vetëqeverisje, ni vetë-autonomi, ni vetëvendosje për vetën se çka mujnë me bo. Kjo ishte ideali jonë për atëherë domethonë. Bashkimi kombëtar e këto, na i shishim dikur në etapa ma të vona, jo... fillimisht duhej me mendu me arritë atë çka mund të arrihej, pastaj m'u zhvillu edhe etapat tjera të zhvillimit të historisë. Mirëpo, domethonë, koncentrimi jonë ka qenë ky.

Literatura që shpërndajshim ka qenë literaturë... për shembull, një ndër librat, për shembull, që ne e kemi shpërnda edhe e kemi lexu edhe e kemi bartë dorë mas dore ka qenë, për shembull, libri për Shotë Galicën, që atëherë ka qenë i ndalum. Libri për Idriz Seferin ka qenë i ndalum. Kanë qenë pastaj disa poezi të botume në Zvicërr prej ilegalitetit që neve na bishin në dorë. Ka qenë ai libri "Kangtë e Lirisë". Libra të ndryshëm nga Shqipnia, romane, letërsisë që tash janë krejt normale edhe munësh m'i gjetë në secilën librari. Absurde ka qenë m'u arrestu njerëzit edhe m'u dënu me kah dhetë vjet pse ka lexu ni libër. Domethonë, ka qenë shumë e tmerrshme, domethonë, kjo. Ose pse ka knu ni kangë ose pse ka shkru ni parollë.

Krejt çka bojshim na, i blejshim disa hamera edhe që tash i duket njerëzve që kurgjo, po për neve ka qenë e jashtëzakonshme. Në ato hamera na i shkrujshim parollat për bashkim, domethonë, "Kosova Republikë", "Ja vdekje, ja liri", kësi gjana kanë qenë. Domethonë, nuk ka pasë... dhe ato i

shpërndajshim te të ritë, i shpërndajshim nëpër shkolla, i shpërndajshim nëpër, i vnojsim nëpër rrugë ose shkrujshim me llak me brushë me ngjyrë llaku shkrujshim, “Kosova Republikë”, “Poshtë Jugosllavia”, kësi tituj kemi pasën.

Më kujtohet niherë në gjimnazin “Sami Frashëri”, atëherë ka qenë “Ivo Lola Ribar”, patëm shpërnda disa trakte të tilla edhe u bo shumë e madhe, po nuk mujshin, hala s’na patën ra bash bash mirë kështu në fije. S’na patën zanë fillin mirë, nuk kishin argumente për me na arrestu. Mirëpo, mirë, përkundër asaj që ne kemi qenë aktivë kemi mbri, për shembull tri vjet të plota me punu në ilegalitet që për moshatarët, për atëherë ka qenë goxha mirë. Do të thotë nuk...

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë komunikimi mes juve? Ku jeni marrë vesh?

Naime Maçastena Sherifi: Po jemi taku na. Kryesisht kemi qenë nxanës të ni klase. Domethonë, na jemi konë mrena ni klase edhe gjatë pushimeve të gjata jemi marrë vesh tek kush po i mbajmë mbledhjet. Zakonisht nëpër familje ju thojsim që e kemi ni nejtë, ni festë, ni diçka edhe mbajshim takime të rregullta te njani-tjetri. Kështu i arsyetojsim. Se na nuk dojsim m’i ngarku edhe familjet me informata, për shkak se rrezikoheshin edhe familjartë domethonë. Na nuk dojsim që me pësu familjet tona për shkak të aktivitetit tonë.

Kanë qenë disa masa, goxha masa mbrojtëse që për moshën kanë qenë goxha mirë të mendume edhe të realizume. Unë e mbaj mend që kur më kanë arrestu mu kanë ardhë tetë punëtorë të Sigurimit Shtetnor, domethonë me dy vetura civile edhe bastisja osht’ bo meniherë mas kthimit tim nga shkolla, prej orarit të msimit. Edhe e kanë bastisë shtëpinë krejt, kanë gjetë çka kanë gjetë. Disa materiale i kanë gjetë edhe i kanë marrë. Pastaj, sa kam qenë une në hetime ata kanë qenë edhe dy herë tjera e kanë bastisë shtëpinë.

Po marrja në hetime edhe pytjet kanë qenë shumë, domethonë në hetuesi, qëndrimi në hetuesi, marrjet e çdo ditshme në pytje, keqtrajtimi fizik që ma kanë bo kanë qenë shumë të vështira. Domethonë, kanë qenë goxha të rana për moshën që kom pasë. Se ne... imagjinoje ti, për shembull, Bujari masanej kur jemi liru mas ni kohe edhe kemi bisedu. Më ka tregu edhe qysh e kanë torturu. I kanë fikë cigare nëpër trup, i kanë... domethonë, kanë qenë tortura të tmerrshme. Edhe të ngjashme i kom pasë edhe une.

Pastaj kam bisedu edhe me vajzat tjera që atje i kom taku në burg. Meniherë masi jemi arrestu na, diku në dhjetor kanë qenë të arrestume edhe Grupi i Vajzave të Pejës, [Hava Shala](#), [Myrvete Dreshaj](#), Zyrafete Muriqi, ka qenë kjo Hidajete Krasniqi. Ni grup i vajzave, nja pesë-gjashtë vajza shumë... Zogë Shala. Ni grup i vajzave shumë të mira të cilat po ashtu kanë qenë shumë të reja, të mitura 18-19 vjeçe të gjitha. Domethonë edhe ato tregojnë tmerrin, kanë tregu për mënyrën e tmerrshme si janë torturu edhe janë rreh gjatë kohës së hetimeve.

Domethonë, nuk ka pasë ndonjë dallim apo ndonjë amnesti në këtë drejtim pse je i mitur apo pse je i ri nuk ka çu peshë. Edhe çka ka qenë ma e dhimbshmja për neve, ma e dhimbshmja krejtësisht ma e randa ka qenë që na jemi torturu prej shqiptarëve, prej shqipfolësve. Prej njerëzve që kanë qenë në shërbim të pushtetit. Domethonë, mu asniherë asni hetues serb as s'më ka marrë në pyetje, as s'më ka keqtrajtu, nuk osht' marrë fare me mu. Por, të gjithë ata që më kanë keqtrajtu kanë qenë shqiptarë. Domethonë, kjo ka qenë ma e dhimbshmja.

Anita Susuri: Dashta me ju pytë edhe niherë për vitin '81 edhe demonstratat. A ju kujtohet ndoshta organizimi? A keni qenë aty kur osht' organizu diçka?

Naime Maçastena Sherifi: Jo, unë kom qenë pjesëmarrëse edhe spektatore e rastësishme e demonstratave. Nuk muj me thanë se unë kom qenë veç 14 vjeçe kur ka ndodhë. Nuk e kom pasë idenë e ni... unë kom bisedu shumë me prindin tem, me babën tem të ndjerë. Ai ka qenë jashtëzakonisht i hapun për këto çashtje. Na ka bo me dije gjithmonë pse na jemi kthy, çka ka përjetu familja jonë edhe ai ka qenë ni idealist mjaft i madh. Ka pasë ni shoqni që të gjithë gati kanë qenë pjesëtar të ilegales, domethonë kanë qenë... këto muhabete në familjen tonë kanë qenë krejtësisht normale, domethonë jonë...

Por, jo, nuk kam qenë unë pjesë e organizimit. Kom qenë vetëm pjesëmarrëse si të gjithë qytetartë e tjerë. E di që me datën 26 mars [1981], kur kanë bo ato demonstratat ma të vështira të studentave në shesh të Prishtinës, ku masi që ka ndodhë demonstrata unë kom dalë me babin tim nëpër qytet edhe kemi pa sheshin në gjendje të tmerrshme. Domethonë, kom pa flokë të kputuna nëpër tokë, taka, sene të njerëzve që kond kanë zonë studenta i kanë sakatu, i kanë rreh aq shumë saqë ka qenë e tmerrshme veç me menu.

Pastaj, në demonstratat e 1 prillit në shkollën tonë, unë kom qenë nxanëse e shkollës "Meto Bajraktari", domethonë krejt grupi jonë kemi qenë nxansë të ni klase edhe të shkollës "Meto Bajraktari". Shkollën tonë e kanë izolu atë ditë, kanë thonë... na kemi qenë në orë të msimit. Kanë thanë, "Nuk duhet me dalë". Edhe ndër tjera, diku në orën e parë të mësimi kanë ardhë nxansat e shkollës "Emin Duraku", ata kanë ardhë me flamura, kanë ardhë në mënyrë të organizume t'u bëritë në oborr të shkollës edhe na kanë thirrë neve. Domethonë, na kanë ftu me iu bashkangjitë demonstratave.

Na, meqenëse i kishim dyrtë e mbylluna dhe kujdestaronin nëpër koridore arsimtarte, atëherë e kemi gjetë ni rrugëdalje tjetër, e kemi gjetë ni dritare në katin e parë prej të cilës me njanën prej koridoreve kemi ikë të gjithë. Domethonë, kemi dalë. Edhe kush ka dashtë me dalë me marrë pjesë në demonstrata jemi dalë të gjithë edhe ju kemi bashkangjitë demonstratave atëherë. Ai grup i fëmive me flamura, kryesisht i të rive 14-15-16 vjeçarë, ju kemi bashkangjitë pastaj grupit të madh të demonstruesve. Edhe kjo ka qenë ajo, domethonë kthesa ma e madhe në jetën tem ku përjetimi ma i, domethonë përjetimi i një krenarie, të njejtën kohë i ni dhimbje, nifare përjetim shumë që më ka lanë mbresa në krejt, po mendoj, jo vetëm te unë po te krejt gjenerata jonë të cilët i kemi përjetu.

Pastaj me 2 e 3 prill, situata ka qenë edhe ma tragjike. Domethonë, se me 2 edhe 3 prill janë vra njerëz. Bash ktu ku osht' Ministria e Shëndetësisë me sa m'kujtohet mu, na ishim prapë grup i fëmive që jo shkonim nëpër konvikte, jo shkonim i dërgonim senet atje, merrnim çarçafa i shpërndanim demostruesve, qepë prej shpive u merrshim për shkak të gazit lotsjellës që hidhej. Shalla, çarçafa, qepë. Aty te, Ministria e Shëndetësisë që osht' ai udhëkryqi, demostruesit, se ka qenë e koncentrueme ni pjesë e demostratave në atë pjesë, në qat' udhëkryq për shkak të Mensës së Studentëve. Se konviktet dhe Mensa e Studentëve vinin prej asaj pjese edhe kryesisht demonstratat '81-shit kanë shpërthyer prej studentave, domethonë prej rinisë.

Ata e kishin marrë, ka qenë ni kombi-bus, a nuk e mbaj mend ni autobus i vogël që e kishin praptu edhe në udhëkryq e kishin pasë vu edhe janë hyp demostruesit me flamura, me autoparlanta t'u folë. Në ndërkohë, atë ditë patën hy, patën ardhë forcat federale të ushtrisë së policisë, jo vetëm të Serbisë po krejt federatës. Edhe kanë hy me tanka në qytet. Ne kemi qenë në qat' pjesën ku ka qenë ajo autobusi edhe ka pasë shumë njerëz. Ata kanë hi përmes turmës edhe i kanë mshu atij autobusit, i ka rrzu krejt njerëzit. E ka shty autobusin edhe janë rrzu krejt njerëzit.

Në ndërkohë, unë kom pa me sytë e mi oficerin kur ka nxjerrë alltinë dhe prej tankut e ka plagos ni student. Domethonë, ka gjujt edhe e ka plagos ni student. Atëherë na kemi qëllu disa të ri aty, në mesin e tyre ka qenë edhe, tash osht' mjeke, doktoresha Teuta Bekteshi, edhe ajo ka qenë studente e mjekësisë. E kemi marrë atë djalin disa të ri, shtatë-tetë vetë e kemi dërgu në ni familje te ato shpijat aty mrapa edhe e kemi fut në podrum. Kanë marrë ia kanë lidhë plagën, e kanë ndalë ni veturë dhunshëm për me mujtë me çu studentin në spital që ai mos me psu prej gjakderdhjes. Këto janë përjetime të një adoleshenteje 14-15 vjeçare domethonë. Pastaj ajo pjesa e burgut kur vishin shoqet tona të torturume i ndihmojshim njana-tjetrës. Ato kanë qenë, secila kanë lanë mbresa, kanë lanë kujtime jo të mira. Shumë të dhimbshme.

Anita Susuri: Si ka ndodhë burgosja e ju? Ku kanë ardhë ju kanë marrë? A keni qenë duke kry ndonjë aktivitet?

Naime Maçastena Sherifi: Jo, jo, unë jom arrestu në shpi. Ju thashë ma herët, ata kanë pritë në kohën kur une kthehem prej shkollës, se ata kanë mujtë edhe në shkollë me më arrestu mirëpo kanë pritë orarin kur unë kthehesha. Dikur, atëherë, unë kthehesha dikur ora 12:30-13:00 përfundojke ora, msimi paraditës edhe kom qenë nxanëse e gjimnazit gjuhësor-kulturor, tash ky Gjimanzi "Eqrem Qabej". Se shkollimi në gjeneratën tonë ka qenë me msim të orientum i thojshin. Dy vitet e para ne i kemi përfundu në gjimnazin "Sami Frashëri", "Ivo Lola Ribar", që u thirrke. Pastaj e kemi pasë orientimin, u ndajke kush dojke me shku në mjekësi, kush dojke me shku në ekonomi edhe unë u pata drejtu në drejtimin kulturor-gjuhësor. Ka qenë, tash gjimnazi "Eqrem Qabej", në Shkollën Normale, në pjesën e prapme të Shkollës Normale ka qenë objekti.

Normalisht që ata kanë mujtë me më arrestu në shkollë, nuk më kanë arrestu sepse kishte me bo shumë bujë. Domethonë, i kanë ikë. As ata s'kanë dashtë, se as për ata s'ka qenë shumë shumë e lehtë, për shembull me marrë me arrestu fëmi. Në këtë drejtim ata kanë qenë të kujdesshëm sa me rujt imazhin për vetën. Mirëpo, ata s'kanë mujtë me mshefë faktin që na jemi arrestu, që jemi marrë, sepse na kemi mungu në shkollë. Pastaj shkolla na ka përjashtu. Unë jom përjashtu. Masi jom dalë prej burgut unë kom marrë, normalisht që me urdhër të Sigurimit Shtetnor, shkolla e kulturologjisë atëherë m'ka lshu vendim që jom përjashtu prej shkolle. Nuk ma kanë bo të mundshme as me provim klasor me marrë vitin, masi jom dalë prej burgut.

Jom arrestu në shpi. Kanë ardhë te shpia, e kanë bastisë. Më kanë marrë më kanë çu në Sigurim Shtetnor, më kanë majtë 72 orë aty. Mas 72 orëve, masi, ata pytjet që i bojshin, domethonë kërkojshin sqarime që unë nuk dojsa m'i dhanë edhe nuk i kom dhanë asniherë. Edhe për ato më thanë, "Ose duhesh me folë për qito pyetje që t'i kemi bo ose ki me nënshkru që po të dërgojmë në Mitrovicë, në burg të Mitrovicës edhe po hapim hetimet edhe paraburgimin për ty", dhe unë kom nënshkru. Më kanë marrë më kanë çu në burg të Mitrovicës.

Anita Susuri: E ato 72 orë, a ka pasë edhe dhunë apo veç...?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po, po. Dhunë ka pasë ni muj. Jo, 72 orë, ni muj. Domethonë, ka ndodhë kanë ardhë më kanë marrë në 12:00 të natës prej dhomës të burgut edhe më kanë majtë në pyetje deri në mëngjes e më kanë keqtrajtu. Ka pasë raste kur unë nuk kom mujtë as m'u veshë, as m'u mathë, as m'u... kom qenë shumë e rrahun. Domethonë, ajo pjesa që ka të boj me ni fëmi... e këto e kom kuptu pastaj kur i kom pa edhe vajzat tjera të grupeve tjera që i sillshin aty. Kjo nuk ish diçka, kjo ish rutinë e punës të tyne që pavarësisht prej moshës, vetëm a ka të boj me politikën edhe sipas tyne, a e ka shkelë ligjin e shtetit edhe të "bashkim-vllaznimit" ata të kanë kputë dajak. Kjo, domethonë, pa mëshirë. Kanë qenë shumë të pamëshirshëm.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: A kanë pasë naj lloj taktike që ka qenë, domethonë që i keni vërejt edhe kur ju kanë tregu tjetër për përjetimet?

Naime Maçastena Sherifi: Normalisht që kanë pasë taktika, osht' shumë e vërtetë që kanë pasë taktika. Për shembull, kanë pasë taktika të thymjes shpirtërore. Mu më kujtohet kanë ardhë ni ditë edhe më kanë thanë që të ka vdekë baba. Unë e kisha babën smutë, ka pasë infarkt. Edhe pse, ai mas pesë muje që dola unë prej burgu ai vdiq, se ai ka qenë i smutë prej zemrës. Edhe më thanë, "Të ka vdekë baba". Tani më thanë kështu, "Okej", une hiç nuk reagoval se thanë, "Na të kishim çu", tha, "ti me pa vorrimin e babës, po", tha, "ti s'po folë. Ti nëse folë, na të çojmë". Edhe aty krejt e dita që kjo osht'

lojë. Thashë, “Okej, une e shoh vorrin e babës kur të dal prej ktuhit”, thashë, “s’po du me më çu hiç”, domethonë, “nuk du me shku me pa vorrimin e babës”.

Pastaj kanë shku ni taktikë tjetër unë e kom pasë n’atë kohë sa isha nën hetime, babi im kishte qenë shumë keq me shëndet edhe e kanë shtri në spital. Kanë shku në spital edhe i kanë thanë, “Ti duhesh me ardhë, me fol me çikën tane me bindë me fol”. A mu kur m’kanë marrë prej burgut edhe m’kanë dërgu në lokalet e sigurimit shtetnor në Mitrovicë, m’kanë thanë, se ishte e dille edhe zakonisht të dilleve ma pak kanë punu edhe ata. Kur erdhën me më marrë thanë, “Ki vizitë”. Mirëpo, nuk po më çojnë në koridor të vizitave, as nuk ishte ditë e vizitave. Thashë, “Ku po më dërgoni?” Thanë, “Po të dërgojmë në zyre”, thashë, “Po çfarë vizita në zyre?” Se vizita, ishte vendi ku bohej vizita. Edhe ato vizita kanë qenë krejt të ndane me grila, e ke pasë distancën, domethonë ti ke pa veç prej ni distance ndoshta dy metra, tri metra ke pa prindin edhe qaq, ose familjarin. Tha, “Jo, jo në zyre”.

Kur shkova në zyre e pashë e kishin pru babën tem edhe ai ishte në gjendje shumë të randë shëndetësore, ishte i kputun. Nuk dojsha ai me më pa në atë gjendje, se unë isha shumë e rrahun. Ftyrën e kisha krejt me hematome, durtë i kisha krejt zi prej pendrekut, nuk mujsha me mathë këpuca. Domethonë, unë kom shku me çorapa prej burgut të Mitrovicës, me veturë më kanë marrë une kom shku në çorape, s’kom mujtë këpucat m’i shti, nuk kom mujtë m’i mbathë këpucat. E thashë, “Nuk po du”, thashë, “me ardhë kështu. Pse e keni pru njerin?” A kupton? Se s’dojsha ai me më pa në atë gjendje. Më thanë kishe po ju lojmë vetëm me folë. Ky ka qenë punëtor i Sigurimit që e kanë vra, Ibush Klllokoqi edhe ni tjetër ka qenë, ni Faik Nura. Tha, “Jo”, tha, “duhesh me folë me babën”, thashë, “Në rregull”.

Si erdh thashë, “Pse më ke thirrë babë?” “Jo”, tha, “une nuk të kom thirrë. Unë s’kom lypë”, tha, “me ardhë, këta kanë ardhë më kanë marrë”. Domethonë, krejt ishte ajo që... thashë, “E çka po dojnë” thashë, “këta?” E atëherë nuk ka pasë, nuk e di sa ka pasë makineri përgjuese, mirëpo kanë pasë. Domethonë, bisedat i kanë përgju edhe atëherë i kanë inçizu. I lanë, ka pasë nifare çante tip koferi, e la të hapun edhe dul në anën tjetër, domethonë edhe tash me na lonë neve me folë. Po unë isha shumë e vetëdijshme që ata janë kah inçizojnë edhe na bonëm muhabet krejtësisht të zakonshëm. Në ndërkohë baba jem t’u dalë kadale, domethonë në vesh më tha, “Kujdes se filanja, filani ju kanë qitë”. Domethonë, ai m’i dha emrat kush ka folë. Qaty unë e mora informatën.

Në moment që e mora informatën se kush ka folë, unë e disha edhe çka dinë ata. A kupton? Për mu ishte shumë e lehtë m’u mbrojtë. Pastaj kanë ardhë prindt herë pas here në vizitë, derisa kemi dalë në gjygj. Në seancë gjyqësore ne jemi, unë edhe Bujari, jemi dënu me pesë vjet burg, por mbrojtje në liri [me mbikqyrje]. Nëse na bojmë diçka mrena pesë viteve, m’u rikthy në burg. Domethonë, kjo ka qenë dënimi që na dhanë. Ndërkaq Teuta Hadri dhe Teuta Bekteshi u dënu me nga ni vjet burg, që nuk ishin dënime shumë të randa.

Por, fati jonë i miri ka qenë që në seancën gjyqësore tre avokatë që kanë qenë mbrojtës tonë, ka qenë Avni Gjakova, Fazli Balaj i ndjeri, edhe Fehmi Baftiu, po ashtu edhe ai i ndjerë. Ata mbrojtjen e patën të shkëlqyeshme, po edhe u kapen [në faktin që...] se në kohën kur ne u dënojmë në Beograd të arrestumë për nacionalizëm kanë qenë edhe Shesheli¹ edhe Drashkoviqi². Dhe ata ni javë përpara ishin liru, domethonë edhe ata [avokatët] u kapën në këtë fakt, mbrojtësit. Qysh po i dënoni dy fëmi edhe dy vajza të reja, përderisa janë liru ni Sheshel edhe ni Drashkoviq nga burgu. Domethonë, edhe gjyqtari Qerim Meta atëherë vendosë për ni dënim ma të butë. Domethonë, edhe kjo ka qenë dënimi që kemi marrë. Teuta Bekteshi dhe Teuta Hadri ni vjet burg kanë majtë, na jemi liru, por me mbikqyrje, me urdhër të mbikqyrjes.

Anita Susuri: A ka qenë kjo për shkak se keni qenë të mitur, jo?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: Përndryshe ishit dënu...

Naime Maçastena Sherifi: Përndryshe ishim dënu. Përndryshe ishim dënu.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë kushtet e burgut? Sigurisht kanë qenë të randa, po nëse mundeni me na shpjegu ushqimi ose vendi?

Naime Maçastena Sherifi: Absolutisht. Tash unë nuk i kam përjetu burgjet e tjera, domethonë e di që qat' 72 orëshin në burgun e Prishtinës që ka qenë ajo dhoma e paraburgimit ka qenë tmerrësisht e keqe. Domethonë, as nëpër filma horror nuk mundësh me pa. Ka qenë ni kthinë e ndame me grila, e ka pasë ni si shtrat prej drunit, nuk ke pasë kurgjo as batanije nuk kom pasë. Për 72 orë që ka qenë kohë jashtëzakonisht e ftoftë, mot shumë i ftoftë mu as batanije aty s'më kanë pru. Domethonë, kom përjetu tmerr prej ftoftit. Pastaj në burgun e Mitrovicës kanë qenë kushtet jashtëzakonisht të kqija. Domethonë, nuk ke pasë, ushqimi ka qenë shumë i dobët, burgu ka qenë si burg shumë i randë. Ka qenë burg i randë hetues.

Bile, bile, unë i numërojsha prej hymjes se kur më merrshin në pyetje më dërgojshin në objektin e Sigurimit Shtetnor në Mitrovicë edhe më kthejshin pastaj në dhomë. Prej hymjes kryesore e deri te dhoma jem ku më mbyllshin u mshelshin edhe u hapshin diku dhetë dyrë. Imagjino ti çfarë burgu dhetë dyrë nëpër koridore t'u u enë çel ni derë e mshel ni derë. Unë i numërojsha dhetë dyrë kanë

¹ Vojislav Sheshel - (*Vojislav Šešelj*; lindur më 11 tetor 1954) është politikan serb, themelues dhe president i Partisë Radikale Serbe të ekstremist të djathtë (SRS). Ndërmjet viteve 1998 dhe 2000, ai shërbeu si zëvendëskryeministër i Serbisë.

² Vuk Drashkoviç - (*Vuk Drašković*; lindur më 29 nëntor 1946) është shkrimtar dhe politikan serb. Ai është udhëheqës i Lëvizjes për Ripërtëritjen Serbe dhe shërbeu si zëvendëskryeministër i Republikës Federale të Jugosllavisë gjatë kohës së luftës në vitin 1999 gjatë sundimit të Slllobodan Millosheviqit. Dhe ka qenë ministër i Punëve të Jashtme të Serbisë nga viti 2004 deri në 2007.

qenë. Domethonë, kushtet e higjienës kanë qenë të qija, kushtet e ushqimit, ushqimi ka qenë shumë i dobët. Gjithçka ka qenë keq, kurgjo mirë s'ka pasë. Trajtimi ka qenë shumë i keq. Në javë dy herë, po mendoj në dy javë, ni herë na lejshin m'u pastru në banjo. Domethonë, tri herë në ditë ke pasë me shku në banjo, dy herë në dite ke dalë kishe në ajër të pastërt edhe ata kah dhetë minuta. Herë na kanë qit', herë s'na kanë qit'. Domethonë, trajtimi ka qenë shumë i keq. Ushqimi ma mos të flasim.

Anita Susuri: Edhe shoqet në qeli, a kanë qenë të gjitha të burgosura politike?

Naime Maçastena Sherifi: Jo, nuk kanë të gjitha të burgosura politike. Në kohën kur kom qenë unë në, në dhomën, në 3-sh kur kom qenë ka qenë një gru e cila kishte vra axhën e burrit në vetëmbrojtje. Pastaj, ka qenë edhe ni kroate-slllovene, nuk di, ajo kish qenë për këtë aferën e gurve të çmushëm edhe rasti Trepça që ka qenë për ari edhe për argjend. Edhe njëna prej atyne ka qenë edhe në qit' grupin e argjendit të Trepçës, ni gru tjetër ka qenë. Pastaj në dhomën, në fakt në 4-sh ka qenë kjo. Në 3-sh kur më kanë çu po, aty e kom pasë Trëndelina Ladolishtin ka qenë, Labënishtin, ajo ka qenë e burgosun politike. Pastaj kanë sjellë edhe vajza tjera, kanë pru këtë Grupin e [Vajzave të] Pejës. Ka pasë për kundërvajtje që kanë ardhë, për ni shkrim të parollës 60 ditë që i kanë dënu ose për ni kangë që e ka knu. Ka pasë edhe për kundërvajtje, por ka pasë edhe për vepra tjera.

Anita Susuri: Në total sa ju ka ra juve me qëndru në burg?

Naime Maçastena Sherifi: Po në total diku rreth pesë muj.

Anita Susuri: Gjatë kohës, domethonë, a ka ndryshu qasja e tyre? A osht' zvogëlu dhuna?

Naime Maçastena Sherifi: Fillimi i hetimeve ka qenë shumë i vështirë, ai muji i parë. Pastaj kur ata kanë llogaritë që kanë përfundu hetimet janë marrë veç procedura gjyqësore, domethonë. Edhe jo jemi dëgju para gjyqtarit hetues, jo jemi, derisa osht' marrë vendimi për m'u mbajtë seanca kryesore gjyqësore, derisa i kanë kry ato procedurat e veta domethonë. Po muji i parë, po, ka qenë shumë i vështirë. Masandej jo. Masandej nëse i ke thy rregullat mrena aty n'burg, domethonë, t'kanë keqtrajtu.

Anita Susuri: Çfarë rregulla ka pasë?

Naime Maçastena Sherifi: Ka pasë rregulla, për shembull, nuk ke guxoftë me ra me fjet gjatë ditës osht' dashtë me nejtë tanë kohën ulun. As në shtrat s'ke guxoftë m'u ulë, po janë konë do shilte që osht' dashtë m'u ulë në tokë. Me bo me të zonë fjetun, të merrshin të çojshin në vetmi. Me knu e ke pasë të ndalume. Na knojshim, domethonë këtu e thejshim rregullin se na knojshim. Nuk i pytshim. Veç vishin na merrshin, pastaj na dërgojshin në vetmi.

Anita Susuri: E në vetmi qysh ka qenë? Sa kohë?

Naime Maçastena Sherifi: Ajo ka qenë ni dënim i përkohshëm, ni orë, dy orë edhe të kanë kthyer prapë aty. Po mirë ka qenë mos m'i thy rregullat. Unë për veti jom kujdes shumë që mos me prur punën me më rrehë ato gardienët edhe me më dërgu në vetmi pa pikë nevojë, a kupton? Edhe pse kom këndu. Po na, për shembull kur kemi këndu zakonisht i kemi pasë disa gardiene të mira që e kemi shfrytëzuar prezencën e tyre kur ato kanë qenë kujdestare. Ato, për shembull kanë qenë ma liberale. Ikshin, e bojshin ni sy çorrr, ni vesh të shurdhër edhe na lejshin ma të lira me komuniku prej dhomë në dhomë, me folë edhe po i shfrytëzojshim qato momente.

Anita Susuri: Çfarë kangë për shembull keni këndu?

Naime Maçastena Sherifi: O shumë kangë patriotike (qeshë). E mbaj mend “Në Dardani bjen ni tupan”, ka qenë një ndër kangtë që atëherë ma së shumti e këndojsim. Ka pasë kangë shumë të bukura. E kjojsim këtë, “Kur na ra Kushtrimi në Kosovë”, tash s'po mbaj mend, kangë, “Moj fusha e Korabit”. Kangë të bukura.

Anita Susuri: Domethonë, patriotike?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: E po më intereson edhe qysh ka qenë gjendja juaj shpirtërore edhe çka keni mendu që ka me ndodhë me juve ma tutje? Qysh keni me vazhdu?

Naime Maçastena Sherifi: Paj, tash ndoshta ka qenë edhe mosha që unë kam qenë shumë e re domethonë. S'di! Unë e meno që prej asaj që unë kom përjetu, unë meno që njeriu burgoset vetëm nëse e ka ni burg mrena trunit të vet. Përndryshe, nëse ti e ki trutin tonë të lirë, domethonë nëse ti nuk e nin vetën të robnume nuk ka sen që të robnon. Nuk munësh m'u... unë kom qenë shumë e re, unë kom bo aktivitete. Për shembull, kom organizu shumë ushtrime fizike, i kom shti m'u marrë me gjimnastikë, me knim, kemi lexu shumë. Jom mundu me kalu kohën në mënyrë shumë të dobishme për vetëvetën domethonë. Kjo ka qenë ajo që m'i mbijetu asaj presionit psikik edhe të qenurit i mbyllur. Në fakt kom lexu shumë, tanë kohën kom kërkua libra prej biblioteke. Kemi pasë bibliotekë aty. Nuk ka qenë ndoshta shumë e rëndësishme çka po lexoj, po kryesorja ka qenë me lexu që truni me qenë aktiv. Edhe me mbush fjalëkryq.

Na i porositshim e pagujshim prej buxhetit që na sillte familja pagujshim “Rilindjen”, e merrshim rregullisht. Domethonë, merrshim revista, lexojshim, mushshim fjalëkryq. Edhe pse ne e kemi pasë të ndalume me majt laps po mushshim fjalëkryq me shkrepza. Domethonë i lagshim shkrepzat, i djegshim edhe me atë i përdorshim si laps. Ose aty këtu e vjedhshim naj fysht kështu, e mshefshim dikund. Veç fyshtin se me ta pa krejt lapsin ta merrshin. Mirëpo, veç ni fysht kimiki e merrshim e majshim qaty. Po ose prej gazetave, më kujtohet me Trëndelinën i patëm lidhë, ka qenë, përpara

“Rilindja” i botojke fejtonet, pjestë, tetë faqet e ni romanit edhe na ato i mbledhshim çdo ditë. E patëm bo libër ni roman.

Më kujtohet ka qenë ky romani “Vasha e dymbëdhjetë varreve” e Emin Kabashit dhe pastaj e kom pasë lonë t’u lidhë edhe librin “Mehmet Imcaku” të Jasha Kemalit, ni shkrimtari turk. Po merrshim, ka pasë aty bibliotekë domethonë. Kur dojshim me shku me kërkua libra kanë qenë të obligum me na çu te biblioteka e na pastaj aty me zgjedhë çka po dojmë me marrë me lexu.

Anita Susuri: A ka pasë edhe shqip libra?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: Shqip?

Naime Maçastena Sherifi: Ka pasë, ka pasë.

Anita Susuri: Kur keni dalë prej burgut, qysh ka qenë qajo ditë?

Naime Maçastena Sherifi: Po na menjëherë pas seancës gjyqësore jemi dalë prej burgut. Në fakt, unë kur kom shku në seancë gjyqësore nuk e kom pasë, nuk muj me thanë që kam qenë e bindur që ka me u liru. Unë kom pritë që kena m’u dënu goxha. Domethonë, kena me marrë naj dënim ndoshta maksimumi pesë vjet. Mirëpo, kom qenë e pregatitur shpirtërisht për ni sen të tillë edhe nuk e kom pasë problem. Por, në gjyq në bazë të rrjedhave që u zhvillu gjyqji, se ka zgjatë goxha shumë atë ditë, diku prej mëngjesit deri ora 3:00 ka qenë kur jena liru. Se mu e Bujarin na kanë liru menjëherë atë ditë. Edhe ka zgjatë shumë, domethonë seanca gjyqësore.

Unë për veti, po të thom, nuk kom pasë bindjen që kena m’u liru as nuk e kom besu bile që kena m’u liru. Po pastaj ajo ka qenë ni befasi, domethonë lirimi edhe dënimi aq i ultë. Se na e kishim... unë për veti e kisha brengë shumë... hajde na të mitun, a din, thojsha maksimumi mujnë me na dënu pesë vjet. Mirëpo. Teuta Hadri, Teuta Bekteshi ishin në moshë madhore edhe ato mujshin m’i marrë dhetë vjet burg. Unë e kisha brengën edhe për to që ato mujnë m’i dënu, domethonë se ishin të rrituna. Po mirë. Kështu shkoi, domethonë mirë keq kështu shkoi seanca jonë. Masi kom dalë prej burgut diku kanë provu me kontakti me shkollën me kqyrë se çka muj me bo.

Në shkollë kur kom shku më kanë thanë, “Jo, ti je e përjashtume”. Edhe aty Sigurimi Shtetnor i ka përzi durtë se ata kanë qenë të përfshimë. Kur kanë marrë dikond, për shembull me ndëshku dikond e kanë ndëshku jashta ligjit e përtej ligjit e... nuk kanë pasë mshirë në këtë drejtim. Domethonë, kanë shku edhe unë shkova m’i kërkua të paktën dokumentet që m’u regjistru për vitin e ardhshëm në shkollë tjetër, meqë s’ma bonën të mundshme me marrë me provime klasore. Kur kom shku m’i kërkua dokumentet më kanë thanë, “Nuk i ke këtu”, edhe m’osht’ dashtë me pritë. Atëherë prindt e mi kanë

shku janë anku në Komitet, ka qenë ai departamenti për arsim. I kanë thanë, “Kjo osht’ liru prej burgut, pse? Ku janë dokumentet e sajna?” Ata kanë dërgu ni inspektim në shkollën e kulturologjisë atëherë që i thojshin edhe dokumentet i kanë gjetë të mbyllura në sirtar, në zyrën e sekretarit të shkollës. Ai i kishte mshef dokumentet.

Atëherë i ka marrë prindi im dokumentet dhe kom apliku në shumicën e shkollave në mjekësi, në ekonomi. Në asnjënen s’më kanë pranë edhe pse unë kam qenë nxanse e shkëlqyeshme. Atëherë jom regjistru në shkollën e bujqësisë, fati që unë e kisha aty profesor ni kusheri timin. Ai bisedon me drejtorin edhe më pranojnë aty. Kom vazhdu prapë klasën e tretë dhe të katërtën të shkollës të mesme në shkollë të bujqësisë, kom përfundu aty. Edhe kështu. Pastaj mbasi kom përfundu shkollën jom regjistru në Fakultet të Bujqësisë. Mbas ni viti e diçka jom martu.

Bashkëshorti im osht’ i anës të Gjilanit edhe këta janë familje të përndjekur politik. Dy kunetët e mi kanë qenë të dënum, njëni pesë vjet, tjetri gjashtë vjet. Kanë qenë familje e përndjekur. Situata u përkeqësu shumë në ‘89-tën, ‘90-ën. Unë edhe ashtu kisha pengesa në shkollim, domethonë në fakultet kisha shumë pengesa. U detyrova për ni kohë masi u martova me pauzu, domethonë e ndërpreva. Linda djalin e madh, vajzën edhe tek masandej në vitin ‘92 prapë kom vazhdu shkollimin, fakultetin. Kom studiu për letërsi edhe e kom kry.

Anita Susuri: Po më intereson gjatë kohës kur keni dalë prej burgut, po thoni që keni pasë këto probleme, po a ka pasë edhe probleme, për shembull të tilla të ksaj natyre që, për shembull me ju marrë në pyetje prapë për diçka që ka ndodhë?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. Më kanë marrë në pyetje. Dikund mas dy jave që jom liru më kanë marrë edhe niherë gjithë ditën në Sigurim Shtetnor në Prishtinë më kanë marrë në pyetje. E nuk më kanë keqtrajtu, po veç psiqikisht kështu e fizikisht jo. Më kanë marrë në pyetje për gjana shumë palidhje, shumë banale. Por ishte ma tepër ni presion psiqik që e ushtrojshin me atë që ti je dalë prej burgut, po na hala po të përcjellim, nuk munësh me bo çka të dush. A po kupton? Po ajo ndjenja e përndjekjes ka qenë, domethonë e ke ditë, e kom ditë tonë kohën e lume që më përgjohet telefoni, na përgjohet domethonë në shpi edhe shumë sene tjera.

Pastaj, në tetor të ‘85-tes, në fakt me 10 tetor, ‘85 mu më vdiq baba. Domethonë edhe kjo ka qenë ni goditje shumë e madhe për mu, nashta edhe ma e randë se burgu. E kom përjetu shumë randë, se ai shkoi shumë i ri 45 vjeçar edhe na mbetëm në Kosovë pa familjarë të ngushtë. Nana jem domethonë edhe dy vllaznit e mi edhe unë. Ndërkaq që krejt halla, daja, axha, krejt familja jetojnë në Turqi. Me përjashtim axha i babit që ka ardhë edhe ai osht’ kthy pas neve, domethonë të tjetrtë komplet ishin atje. Edhe kjo largësi, domethonë situata politike që zhvillohej në Kosovë, pamundësia për me kontaktu familjen, shumë vështirësi tjera domethonë na kanë ndjekë tanë kohën e lume. Kështu.

Anita Susuri: Pas burgut ju e keni ndërpre mo aktivitetin?

Naime Maçastena Sherifi: Jo, na jemi taku masi osht' dalë edhe Teuta Bekteshi... jo si grup, domethonë e kemi ndërpre aktivitetin si grup që kemi qenë i të miturve, sepse ma nuk kish kurgjo ilegale. Se na ma veç u dike që krejt grupi kemi ra përneherë edhe osht' dënu kush osht' dënu, tjetër janë liru. Kështu që, na nuk dojshim ma me rreziku ma tutje edhe ata tjetër m'i... shife, kur dulëm prej burgut ka qenë ajo ndjenja që ti u dashtë gjithmonë me pasë kujdes, se njerëzit kanë pasë frikë me të pa. Nuk kanë pasë frikë me ty m'u taku në qytet, sepse ata e kanë ditë se ti je i përndjekur edhe ty dikush vazhdimi ka me të përcjellë. Ka qenë ajo fobia, ajo frika e njerëzve. Edhe normalisht ka ndodhë ajo që ti ke taku arsimtarin e klasës që të ka dhanë msim edhe kur të ka pa e ka kthi krytë se s'ka guxu me të folë.

Domethonë, këto kanë qenë përjetime që ne i kemi përjetu rëndë, domethonë i kemi mbajtur në mend edhe lojnë vragë tanë jetën. Nuk osht' e lehtë njerëzit me pasë frikë me folë me ty për shkak se nesër, masnesër dikush i përcjellë edhe mujnë me psu si ti. Kjo ka qenë ajo fobia që e ka kriju pushteti, frika që ka kriju në popullatë te qytetarët për komunikim mes veti. Aq ka qenë kontrolla e madhe, qaq ka qenë represioni i madh, saqë njerëzit edhe me mendu kanë pasë frikë. Dhe kjo ka qenë ajo pushtimi i rëndë që kemi përjetue. Edhe me mendu kanë pasë frikë.

Anita Susuri: Edhe ni detaj që m'u kujtu, e di që në ilegale ka pasë edhe pseudonime...

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: A ka pasë...

Naime Maçastena Sherifi: Po, po, po. Unë e kom pasë pseudonimin Fato. Kështu më kanë thirrë. Bujarin e kanë thirrë Sokol. E Teuta ka qenë Flora, njëra ka qenë Lulja. Qishtu.

Anita Susuri: Këto janë bo për shkak që me...

Naime Maçastena Sherifi: Po, konfidencialiteti i sigurisë që mos m'u marrë vesh. Jemi mundu ni siguri me bo për veti, për tjetër. Sukses ka qenë me punu në aktivitet edhe mos me ra. A po kupton? Ka qenë e suksesshme. Po edhe me ra nuk ka qenë e jashtëzakonshme, sepse na kemi qenë jashtëzakonisht të vetëdijshtëm që ai regjim, ai regjim ka qenë shumë totalitar dhe shumë i keq. Në momentin që njerëzit kanë ra, kanë përdorë aq shumë dhunë saqë s'ka qenë, nuk ka qenë e habitshme nëse ai ta ka qit' emrin dikush kur osht' hy në durë të tynve. Se s'munet çdokush m'i qëndru dajakut edhe nuk osht', osht' krejtësisht normale. Unë për veti asniherë nuk i kom gjyku edhe ata për të cilët e di që kanë folë për mu edhe që më kanë qit' mu. Asniherë s'i kom gjyku se edhe ata kanë qenë njejtë sikur unë femi.

Anita Susuri: Po më intereson, a keni pasë edhe, si me thanë, mënyra tjera që keni komunikuar? Që ka qenë me kode apo diçka?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. I kemi pasë disa metoda që i kemi përdorë, domethonë të komunikimit mes veti, në shoqni mos me dyshu të tjetër që na po bojmë diçka domethonë. Na kemi qenë mrena në klase dhe pothuajse kërkush përveç grupit tonë në klasë nuk e ka ditë çka bojmë na. Domethonë, i kemi pasë ato kodet e komunikimit, kohët kur jemi taku, qysh e kemi shfrytëzuar situatën, domethonë, po.

Anita Susuri: Çfarë kode kanë qenë, për shembull, nëse nuk janë sekret?

Naime Maçastena Sherifi: Po për besë tash nuk po e mbaj mend, për shembull i kemi pasë me në lloj përshëndetje e kemi tregu kohën kur kemi me u taku ose ku kemi me u taku, a kupton? Kështu diçka i bojshim që mos me u marrë vesh prej tjerëve. Kemi qenë me në ambient, me në klasë, shokë klase.

Anita Susuri: Po më intereson për juve edhe karshi kësaj jete aktive politike, a keni pasë kohë edhe për jetë kulturore, shoqnore për shembull? Me dalë diku ose në teatër ose kinema?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po, po. Unë e kam përcjellë shumë Teatrin Kombëtar të Prishtinës. Domethonë, pothuajse i kom shiku shumicën e shfaqjeve që janë dhënë në Teatrin Kombëtar. Kinemanë e kom përcjellë, për shembull në atë kohë kur u bojshin ky filmi, “Njeriu prej dheu”, “Rojet e mjegullës”, janë konë nifare shfaqje që u jepshin, koncerte të ndryshme. Po, kemi marrë pjesë.

Anita Susuri: Qysh janë pritë këto prej publikut? Filmat shqip?

Naime Maçastena Sherifi: Mirë shumë, mirë shumë. Edhe ka pasë interesim shumë të madh në atë kohë, sidomos për kinemanë ka pasë interesim shumë të madh. Vishin, në kohë para ‘81-tës mbaj mend që vishin filma prej Shqipërisë, domethonë vishin në Kinemanë e Prishtinës kryesisht në Kino Rinia edhe na me prind shkojshim i shikojshim ata filma. Për shembull, ka ardhë “Tingujt e luftës”, filmi pastaj kanë qenë disa filma që u patën dhonë, “Zoja nga qyteti”, u patën dhonë në kinemanë e Prishtinës. Normalisht na krejt qytetartë e Prishtinës me një interesim të jashtëzakonshëm i kemi përcjellë ata filma. Kanë qenë ngjarje të jashtëzakonshme. Ansambli Shtetnor i Shqipërisë kur kanë ardhë në Kosovë, domethonë koncertet që i kanë mbajtur.

Anita Susuri: A ka qenë problem për me siguruar bileta për shembull?

Naime Maçastena Sherifi: Po, ka qenë problem. Në ‘84-tën para se me ra në burg, verën e fundit të ‘84-tës që shkova unë në Turqi me vllaun tem, se zakonisht unë pushimet verore i kalojsha atje. Masi e murrëm shtetësinë, se në ‘80-ën e morëm shtetësinë, domethonë diku nëntë vjet kemi nejt pa shtetësi. Edhe në ‘84-tën une me vllaun e dytë shkumë në Turqi në pushime verore, shkumë te axha. Në

ndërkohë, axha im tregoi, axha im në Turqi, se ai ka pasë kontakte të jashtëzakonshme me Ambasadën e Shqipërisë atje atëherë edhe tha, “Osht’ Ansambli Shtetnor i Shqipërisë, osht’ në koncert në Stamboll”, në amfiteatrin e Stambollit mbahej. Ni amfiteatër antik osht’ shumë i bukur.

E di që kemi shku krejt familja, domethonë krejt familjartë e kemi pa atë koncert. Ka qenë koncert i jashtëzakonshëm atëherë edhe kanga e famshme e Fatime Sokolit, “Rroftë Kosova Republikë”, e ka pasë shumë qytetarë shqiptarë të Turqisë edhe turqi aty në koncert që e kanë përcjellë. Mbaj mend që me veturë kur kemi shku kemi pritë diku rreth tri orë në kolonë për me hi te amfiteatër. Domethonë, ka qenë ni interesim i jashtëzakonshëm.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Vitet e ‘90-ta kanë qenë shumë të vështira, por po më intereson qysh kanë qenë ato për juve? Me çka jeni marrë?

Naime Maçastena Sherifi: Po.

Anita Susuri: Po më duket në ‘94-tën keni fillu me KMDLNJ?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. Unë ju thashë ma herët, ‘89-tën jom martu edhe pastaj mas ni vjeti kom pasë djalit e madh Korabin, meniherë mas ni vjeti kom pasë vajzën, Kaltrinën. Edhe pastaj kom vazhdu studimet. E ‘94-tën, në fakt punojke kunati jem në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut edhe ai ka qenë ish i burgosun. Ata u detyrun me migru në Zvicërr edhe unë e pashë ni mundësi që muj me fillu me punu aty. Kisha shumë qef me punu për shkak se më duket që ishte institucioni i vetëm shumë kredibil për kohën. Fakti që mu më lidhke me kontaktet, me ish të burgosurit politik, me krejt aktivistat ishte atëherë ni frymë e tillë që vlojke veni, domethonë vlojke gjithçka. Ishte situatë shumë e vështirë.

Krejt ngjarjet që u zhvillun, jo grevat e minatorëve, demonstratat e ‘98-ës, vrasjet, arrestimet masive, pastaj uzurpimi, suprimimi i autonomisë, largimi i njerëzve nga puna, përkeqësimi i situatës ekonomike të familjeve, sepse njerëzit mbetën pa punë, ikja e njerëzve jashtë për shkak të pasigurisë edhe për shkak të mos, se s’kishin qysh me ekzistë. Në momentin që u largojshin njerëzit prej pune, me çka m’u marrë? Ti i shishe profesorat t’u punu në treg, t’u punu taksista në të zezën, domethonë ishte ni situatë jashtëzakonisht e vështirë, e randë për popullin tonë.

Normalisht që ne kemi qenë pjesë e qasaj jetës të përditshme. Unë në ‘94-tën kur kom fillu aktivitetin tem, fillimisht kom fillu me punu me degën e KMDLNJ-së në Prishtinë. Pastaj pas ni periudhe të shkurtë kom kalu në zyrën qendrore të KMDLNJ-së. Edhe jom marrë me sektorin e informimit domethonë, me pregatitjen e raporteve javore domethonë. KMDLNJ ka pasë informata ditore

vazhdimisht. Ka pasë raportin javor që çdo javë e botojke edhe e qitke në internet edhe e shpërndajke për media edhe raportin e ngjarjeve domethonë. Raporti ka qenë i përbamë prej informatave që mbledheshin nga tereni për shkeljen e të drejtave të njeriut që boheshin [shkeljet] nga regjimi dhe pushteti.

Unë kom punu, domethonë krejt paralufte në atë fushë, në përpilimin e raporteve javore. Kur ka pasë nevojë kemi dalë edhe kemi marrë deklarata të njerëzve për rastet të ndryshme që ndodheshin. Kish raste që vinin aty në zyre jepnin deklaratat, kish raste që detyroheshin me shku nëpër shpija m'i marrë intervistat të tyne m'i pytë për atë çka ka ndodhë. E kemi pasë ni rrjet jashtëzakonisht të madh të aktivistave të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Diku vlerësohet që kanë qenë mbi tre mijë anëtarë se të gjitha qytetet, qytezat, të gjitha fshatrat kanë pasë nga një përfaqësues, nga një person kontaktues me KMDLNJ-në. Edhe informatat i kemi marrë na në mënyrë sistematike prej tyne, qoftë të dërgume përmes faksit, qoftë me telefon, qoftë me informata të shkrueme me dorë që i sillnin aty.

I kemi pasë ata formularët që ata i plotësonin në teren edhe na sillnin. Ka qenë ni punë voluminoze e qytetarëve që kryesisht kanë qenë ose aktivista politikë ose ish të burgosur politikë ose mësimdhansa. Njerëz të profileve të ndryshme. Po ajo çka ka qenë me randësi ka qenë që qytetari i Kosovës ka besu në kredibilitetin e punës së KMDLNJ-së domethonë. Edhe si institucion kemi pasë ni kredibilitet ndërkombëtar. Tonë që e kanë vlerësu të gjitha kontaktet ndërkombëtare që kanë ardhë vizita të ndryshme qoftë nga international, nga organizata të ndryshme botërore ka qenë e pamundur me ardhë në Kosovë edhe mos me vizitu KMDLNJ-në. Domethonë, na kemi punu ni punë jashtëzakonisht të madhe aty, që mendoj që ka shumë vlerë historike, vlerë kombëtare edhe që duhet një ditë me thonë, kjo vlerë kombëtare të sistemohet edhe të mbrohet nga shteti.

Ndoshta për periudhën e viteve '80-ta dhe '90-ta historia e Kosovës gjindet në KMDLNJ. Domethonë, qashtu ka qenë sistemi i punës saqë gjithçka që ka ndodhë mrena 24 ore në Kosovë na e kemi pasë informimin. E thojnë edhe... mbaj mend për shembull, një ndër aktivistat ma të njohur tonë ka qenë Halil Barani në Mitrovicë. Ai, për shembull çdo 15 minuta neve na ka dërgu informatë me faks. Për gjithçka që ka ndodhë mrena territorit të komunës së Mitrovicës. Kanë qenë aktivista të jashtëzakonshëm. Ni pjesë e madhe e tyne pastaj kanë marrë pjesë në luftë, ni pjesë janë arrestu. Ka prej atyne që për shembull, ka qenë njeni i komunës së Prishtinës që osht' vra nga forcat serbe veç pse ju ka gjetë bexhi i KMDLNJ-së me veti. Domethonë e kanë ekzekutu.

Ka qenë ni punë e jashtëzakonshme. Unë për veti e mbaj në kujtesën time si ni periudhë e një pune që ka pasë shumë efekt pozitiv në historinë e Kosovës për të ardhmën e Kosovës. Sepse osht' punu shumë edhe na e kemi informu krejt botën për represionin, për dhunën, për krimet që ndodheshin në Kosovë. Domethonë, kem qenë ni burim i jashtëzakonshëm informatave për me njoftu faktorin ndërkombëtarë se çka osht' kah ndodhë. Domethonë, mos m'u... sepse historikisht në Kosovë kanë ndodhë këto gjatë njëqind viteve të fundit, por nuk ka pasë ndonjë sistem të informimit, me përjashtim të disa. Për shembull, për vitin 1912 diku ka qenë ni, ni nuk e di, diplomat, apo çka ka qenë, tash e ka

shkru këtë librin “Golgotat shqiptare”, që ka shkru për krimet edhe masakrat për vitin 1912 të shqiptarët e Shkupit e të Kosovës.

Por, ato janë shkrime të hujve e të shqiptarëve shënime nuk ka pasë. Asniherë nuk u ditë saktë sa njerëz janë vra, sa shumë janë vra që ka qenë në gjenocid në veti. Në libër shkrun se diku në një periudhë shumë të shkurtë 150 mijë vetë janë ekzekutu nga forcat serbe domethonë. Kjo osht’ në punë e madhe që thjeshtë ka determinu ma vonë pastaj zhvillimet politike në Kosovë.

Anita Susuri: A ju kujtohet ndonjë rast specifik diçka që ju ka ndodhë apo keni qenë prezente gjatë atyre viteve?

Naime Maçastena Sherifi: Më kujtohet që gjatë ‘89-tës, në kohën e demonstratave të ‘89-tës kanë qenë dy-tri herë në shtëpi më kanë kërku për me më arrestu, domethonë se i mbledhshin kanë e kanë pasë evidencë që kanë qenë përpara në burg. Por, fati i mirë i jemi që nuk ju kom ra në dorë edhe ma kanë hekë dorë edhe ata. Në këshill sa kom punu vet personalisht nuk kom qenë unë e atakume, nuk më ka ndodhë ndonjë rast i atakimit domethonë, por e kemi ditë që vazhdimisht jemi nën vëzhgim domethonë. Vazhdimisht veturat e Sigurimit Shtetnor janë sillë rreth objektit ku kemi qenë na të vendosun.

I kemi pasë zyret në në sallë të, tash Fakulteti i Fesë Islame, mrena medresesë në Prishtinë edhe zyra jonë ka qenë publike, ka qenë e hapun, ka qenë e regjistrueme si zyrë, si organizatë joqeveritare. Ka qenë e regjistrueme atëherë, me sa e di une, në Beograd osht’ m’i regjistru edhe kemi pasë kontakte të jashtëzakonshme me të gjithë aktivistat. Në kohë sa kam qenë une, ka qenë kryetar Adem Demaçi, për të cilin unë kam në respekt edhe osht’ nifare forme idhulli jem në aspektin politik në Kosovë. Edhe të gjithë këta të burgosur politikë kanë qenë aty pjesë e punës e KMDLNJ-së. Profesori i nderum [Pajazit Nushi](#), Ymer Jaka dhe shumë emra tjerë që janë ftyra publike në Kosovë.

Osht’ bo në punë e jashtëzakonshme, kom pasë në kolektiv jashtëzakonisht të mirë. E kam pasë në atë kohë kur kam qenë une ka qenë Halime Morina, ka qenë Violeta Hamiti, ka qenë Arjeta Emra. Tash osht’ drejtoreshë e British Council këtu në Prishtinë. Mimoza Ahmeti ka qenë, Fahrije Qorraj ma vonë, ka qenë Ibrahim Makolli, Basri Berisha, ka qenë [Nazlije Bala](#), ka qenë, plot domethonë që sot janë shumica prej tyne janë ftyra publike. Bexhet Shala, sekretar të zyrës e kemi pasë Bexhetin në kohë shumë të gjatë. Po osht’ bo në punë e jashtëzakonshme.

Anita Susuri: A keni marrë pjesë ju në këto demonstratat gratë që i kanë organizu?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: Me çelsa...

Naime Maçastena Sherifi: Me çelsa, me bukë e me letra të bardha, me, për 8 mars më kujtohet ajo me letra të bardha që kërkonim paqe, bukë për Drenicën e, po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë këto?

Naime Maçastena Sherifi: Po kanë qenë organizime jashtëzakonisht...

Anita Susuri: Çka ju kujtohet?

Naime Maçastena Sherifi: Po mirë, organizime të mira kanë qenë. Janë majtë shumë aktivitete të ndryshme atëherë edhe kjo, domethonë vitet e '90-ta filloi edhe viti i aktivizmit të grave. Domethonë fillunë edhe oj-q-të e para të grave, "Motrat Qiriazit", kjo shoqata, "Qendra për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Grave" në Prishtinë, pastaj ka qenë kjo një shoqatë "Elena" me sa e mbaj mend unë. Kështu kanë pasë fillu këto shoqatat e para të grave, aktivizmi i grave në Kosovë.

Anita Susuri: Periudha e luftës a keni qenë këtu apo?

Naime Maçastena Sherifi: Deri me 24 mars, po kom qenë. Me 24 mars kom udhëtu për Turqi me fëmijë, e kisha djalin e vogël diku në vjeç edhe këta dy mdhejtë, njani ka qenë shtatë edhe tetë kështu. Deri në ditën e fundit, domethonë të bombardimeve unë kom rezistu s'kom dashtë me dalë nihere. Mirëpo, insistimi i madh i familjes që, edhe familjes të burrit edhe familjes time që me shku m'u strehu me shku për Turqi ishte shumë i madh. Mbet bashkëshorti me prind në Kosovë, në Prishtinë ndërkaq që unë udhëtova me nusen e vllaut edhe me motrat e nuses të vllaut, udhëtum bashkë për Stamboll. Atje më pritke pjesa tjetër e familjes.

Kemi kalu në rrugëtim të tmerrshëm me autobus. Ka qenë ditë e tmerrshme për mu, shumë e kom përjetu rond. E kom përjetu rond ma së pari që u detyrova m'u largu. E kom përjetu rond frikën, sepse kemi udhëtu me autobus nëpër, kemi ra nëpër Gjilan prej Gjilanit në Bujanovc pastaj kemi udhëtu nëpër Serbi ditën e bombardimeve edhe ka qenë si film horror. Domethonë i kemi ra trup prej Bujanovcit e deri në, ku ka qenë ai qyteti, afër Pirotit që kalojshim për Bullgari. Aty Nish e Leskovc edhe krejt këto qytetet. Nuk na ka ra me pa asni njeri të gjallë n'rrugë. Na veç pritshim kur të na ndalin edhe të na masakrojnë.

Ishim autobusi i pari edhe i vetmi që na lshunë me udhëtu, të tjetër krejt i kthyn mrapa se shumica ishin mashkuj. Ndërsa autobusi jonë kryesisht kemi qenë gra edhe fëmijë, krejt katër burra i kemi pasë në autobus. Kanë qenë dy udhëheqësit e autobusit, shoferat edhe kanë qenë edhe dy burra tjerë. Njani ka qenë i moshum, njani ka qenë ma i ri. Tjerat krejt kemi qenë gra edhe fëmijë. 104 vetë kemi qenë në autobus me gra edhe me fëmijë. Ka qenë udhëtim i tmerrshëm sepse derisa kemi mbërri në Bujanovc çdo dy kilometra na kanë nalë policia, post blloqet e policisë. Kanë hy në autobus me maska, pa maska, me automata u tmerrojnë fëmijë. E kemi kalu edhe atë.

Kur kemi hy në Serbi pastaj ka qenë ai tmerri i frikës psikike, për shkak se nuk shishe njerëz në rrugë. Krejt ishin, dritaret me roleta, veturat asnjë nuk kish në rrugë, krejt rrugtë e hapuna. Na kemi kalu rrugën nuk na ka nalë kurrë kërkush. Kemi mrri në Bullgari. Kur kemi mrri në Bullgari na kanë thanës, “Jeni autobusi i vetëm që jeni leju me kalu. Të tjetër krejt i kanë kthy”. Domethonë, në Bujanovc i kishin kthy te mas. Bile, bile njënin prej autobusave më kujtohet ka qenë i Selo Tursit, të gjithë udhëtarët i kishin pasë rreh i kishin pasë kputë se kanë qenë krejt, kryesisht kanë qenë mashkuj.

Kur kemi mrri në Maqedoni, atje në Bullgari diku në ora 8:00 në mramje jemi ndalë diku me hongër darkë edhe e kemi pa prej lajmeve të Euro News bombardimet domethonë. Po ideja ka qenë që këta s’kanë me mujtë me rezistu edhe une kam shku me atë bindjen që okej na po shkojmë, po mrena javës ka me përfundu lufta ,se nuk e besojshim që kanë me rezistu 75 ditë bombardime, a po kupton? Kur kom shku në Turqi kemi mbrri të nesërmen, kanë dalë familja më kanë marrë. Mu më mbetë këtu burri edhe vllau, vllau i dytë. Edhe pse vllau i madh kishte shku më herët me fëmi atje.

U vendosem te familjartë tonë, kushtet ishin jashtëzakonisht të mira. Po unë e kisha brengën e bashkëshortit këtu që mbetë, nuk e disha çka po ndodhë me to. Të nesërmen u bombardu posta e vjetër e Prishtinës edhe me qat’ rrjet telefonik u shpëputen krejt telefonatat, domethonë nuk kisha mundësi ma me komuniku me bashkëshortin. Pastaj mora vesh që lagja jonë ishte deportu, por për këta nuk mujsha me kuptu kurgjo. Derisa mas ni kohe ni i afërm ka shku, kunati jem ka porositë prej Zvicrrës edhe ka shku ka gjetë, i ka pa që janë të mbyllun në shpi, po që janë në izolim total edhe që janë në gjendje shumë të keqe.

Si ka përfundu lufta, normalisht, unë si e kom marrë vesh që veç po hyjnë forcat e NATO-së në Kosovë, unë meniherë në mundësinë e parë, domethonë që mu ka dhonë m’u kthy unë jom kthy me fëmitë e mi (qeshë). Edhe jom ardhë në Prishtinë, me 27 qershor [1999] jom kthy në Prishtinë. Për mu ka qenë ditë e jashtëzakonshme. Ni gzim i dhimbshëm. I dhimbshëm për shkak se kur kom ardhë në Prishtinë, gjendja ka qenë shumë e keqe. Domethonë, gjysma e qytetit ishte i zbrazun, ma shumë se gjysma. Shifshe aty-ktu shpija të djeguna aty-ktu. Shpija të plaqkituna, dyrë të hapuna, a din, ni ashtu, sikur në filma horror. Po tani kadal-dale e morëm vetën.

Anita Susuri: E vendi ku keni jetu ju, në çfarë gjendje ka qenë?

Naime Maçastena Sherifi: Ku?

Anita Susuri: Shpija juj për shembull? Banesa?

Naime Maçastena Sherifi: Na jetojmë në lagjen e Kacallarëve që osht’ aty mrapa Parkut të Qytetit, osht’ kjo përpara osht’ qujtë Rruga “Morava” ka qenë e banume kryesisht me romë. Domethonë, nja shtatë-tetë shpi, maksimumi dhetë shpi kemi qenë shqiptarë e rruga sipër krejt kanë qenë romë. E ata

kanë bo shumë tmerre atëherë. Romtë kanë bashkëpunu shumë me forcat serbe fatkeqësisht, qajo pjesë e banorëve aty. Jo të gjithë romtë, egjiptiast e ashkalitë e Kosovës, por ajo pjesë e romëve kanë bo shumë keq. Kanë plaqkitë shumë, kanë bo sene shumë të kqija nëpër qytet. Kur jam kthy une, unë i kam gjetë ata duke ikë, domethonë në kohën kur jom kthy në shpi ata kanë qenë t'u u bartë me autobusa të Serbisë, shkojshin për Serbi.

Fatkeqësisht edhe ajo ka qenë e dhimbshme edhe ajo pjesë, sepse edhe aty kom pa gra e fëmi t'u ikë, t'u i lshu shpijat që përsëritej domethonë dhimbja në tona antë. Të vike keq për situatën në cilën i shishe. Mirëpo, pasiguria, po mendoj, ata krijun panikë edhe pasiguri për shkak të veprimeve që i kishin bo ni pjesë e tyne. Domethonë, edhe u largun. Përndryshe, forcat militare në atë lagje kanë plaqkitë shumë, domethonë në ato çka ka rrëfy bashkëshorti jem, aty kanë ndodhë sene të tmerrshme. I kanë plaqkitë shtëpitë, i kanë qit' njerëzit dhunshëm prej shpijave, i kanë nxjerrë dhunshëm, iu kanë marrë senet nëpër shpija. Domethonë, ka qenë situatë shumë e tmerrshme.

Gjatë kohës sa kanë qenë bombardimet, për shembull shpinë tonë e kanë bastisë disa herë, domethonë paramilitarë e polici e.... Kanë kërku bashkëshortin tem, po asniherë s'kanë mujtë me gjetë se ky osht', n'kohën kur kanë ardhë... pozicioni i shpisë është fatmirësisht që s'kanë mujtë ata direkt me hi. Këtij gjithmonë iu ka dhonë mundësia për m'u siguru, m'u mshefë që mos me arrestu. Edhe herën e fundit...

Anita Susuri: A ka qëndru në qat shpi?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. Herën e fundit kur kanë hy e kanë rreh vjehrrin tim, domethonë kanë marrë disa gjana. Aty kanë qenë të vendosun edhe ni mik i familjes tonë, domethonë ata kanë pasë ardhë prej ni qyteti tjetër. E atyne ua kishin pasë arrestu djalin aty mrena shpisë tonë. Domethonë ua kishin marrë ni veturë edhe ua kishin arrestu djalin. Kështu. Domethonë, përjetime shumë... bile, bile hera e fundit kur kishin pasë hy në... osht' ni banesë aty përballë neve, ata kishin pa që po hijnë forcat. Ka qenë ni familje gjakovare që s'kishin pasë dalë. Edhe ata pastaj kanë tregu që kur kanë hy forcat paramilitare ne e kemi ditë që këtu ka me ndodhë diçka shumë e keqe, domethonë se kanë ardhë në numër shumë të madh edhe kanë ardhë bash kështu paramilitarë të...

Anita Susuri: Po më intereson pastaj pas luftës, si ka fillu rimëkëmbja te familja juj?

Naime Maçastena Sherifi: Po pas luftës, unë meniherë kom vazhdu punën në KMDLNJ. Kom punu aty edhe për dy vjet, domethonë, '99 deri në 2001-tën. Në fillim 2001-tës kom kalu në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve. Atëherë kom fillu ma shumë m'u marrë me çështje të grave edhe aty kom punu deri në 2016-ën. Dymbëdhjetë vjet kam qenë drejtoreshë e asaj qendre ma vonë. Na e kemi pasë strehimoren për gratë e dhunës, ende ekziston ajo qendër edhe punon.

Unë kom hapë pastaj edhe strehimoren në Mitrovicë për dhunë në familje. Ma vonë edhe ajo u hap si qendër në veti edhe kom pasë hapë qendren në Drenas, kjo Kadirja që e ka. Me Kadirën e kemi hapë bashkë qendrën në Drenas. Ma vonë edhe ajo u pavarësu prej qendres tonë. 2016-ën unë u largova prej aty për shkak se mundësitë për me mbajtë financiarisht ishin jashtëzakonisht të mdhaja, presioni shumë i madh. Kërkohej ni punë jashtëzakonisht e madhe që thjeshtë unë ma nuk kisha fuqi shpirtnore me përballu atë presion të punës edhe e kom lanë. Kom pushu tani nja ni vjet edhe mas ni vjeti kom fillu me punu këtu.

Anita Susuri: Tash punoni në komision...

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: Qysh po ju shkon tash puna?

Naime Maçastena Sherifi: Paj, mirë, mirë. Këtu puna jeme lidhet kryesisht me punime e vendime për kompenzim edhe futjen e të dhanave në... se kryesisht, ma së pari osht' ni procedurë këtu që bohet edhe duhet ato procedurat e shqyrtimit nga komisioni me kalu pastaj m'u kompletu dokumentet, m'u fut në bazën e të dhanave edhe prej aty m'u nxjerrë vendimet për kompenzim. Krijohet lista, çohet në ministri, domethonë janë disa procedura këtu.

Anita Susuri: Te kompenzimi i ish të burgosurve?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po. Ndërkaq në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve unë kom punu shumë në fushën e dhunës në familje, fushën e trafikimit. Kom qenë pjesë e të gjitha grupeve punuese për hartimin e ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, ligjin për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, procedurat standarde për trafikim, procedurat standarde të funksionimit të strehimoreve. Bile, bile hartimin e procedurave e kom bo vet të funksionimit të strehimoreve. Ni kohë të gjatë kom qenë, për nja tetë vjet kryetare e koalicionit të strehimoreve. Mirëpo. ish ni aktivitet shumë i madh, shumë i dendun që thjeshtë unë dikur ma u lodha shumë.

Anita Susuri: Desha me u kthy me folë pak për ni periudhë ma të hershme. Për historinë e familjes në 1912. E përmendët që janë dëbu prej Kosovës për Turqi, a dini edhe diçka ma shumë?

Naime Maçastena Sherifi: Po krejt çka di une osht' rrëfimi që e kom dëgju prej gjyshes teme, prej nanës të nanës. Ajo ka vdekë 102 vjeçe edhe ka qenë shumë e freskët në kujtimet e saja domethonë. Ka mbajtë në mend shumë edhe e ka përshkru shumë interesant mënyrën si janë largu prej Kosovës. Domethonë, rrëfimi i saj. Përndryshe, nuk kom pasë ndonjë të dhanë tjetër. Ajo rrëfente që në 1912-ën, kur kanë hy forcat në Kosovë domethonë shumë familje shqiptare i kanë nxjerrë dhunshëm prej shpijave. Ajo tregojke thojke, "Neve na kanë nxjerrë dhunshëm edhe çka kemi pasë... kemi ikë, me kerr me kije, krejt çka kemi gjetë nëpër shpi që na u ka dokë e nevojshme e kanë marrë të rritunit me vete.

Unë si fëmi kom qenë” thotë, “edhe e mbaj mend që kemi udhëtu disa ditë”, thotë, “me kerr me kije”. Derisa kanë mrri me siguri në Selanik, sepse masandej udhëtimin e përshkrun me tren.

Në fakt, jo. Jo në Selanik por deri në Turqi kanë shku me kerr me kije. Thotë, “Kemi qenë”, thotë, “ndoshta diku rreth 30-35 anëtarë të familjes”, thotë, “që kemi udhëtu bashkë”, thotë, “gjysma kanë vdekë rrugës”, thotë, “atje kemi mrri dikun”, thotë, “15 vetë”, thotë, “në mesin e atyne që kanë shpëtu”, thotë, “ka qenë gjyshja”, e sajna e cila kishte pasë ni sasi të lirave, parave. Lirave të arit me veti. Thotë, “Kur na kanë dërgu atje në Bafër masi kemi mrri në Turqi”, thotë, “na kanë dërgu në Bafër”, thotë, “atje”, thotë, “na kanë vendosë në shpija të armenëve”, se atëherë ka qenë ai spastrimi etnik që Turqia e ka bo ndaj armenëve.

Perandoria Osmane i kanë mbyttë armenët, i kanë dëbu prej shtëpijave, i kanë ekzekutu, i kanë nxjerrë prej shtëpijave edhe aty i kanë vendosë shqiptartë në shtëpiat e tyre. Thotë, “Pastaj”, thotë, “menjëherë na kanë marrë mashkujt çka kanë qenë të rritun edhe i kanë dërgu në luftë. Domethonë edhe kjo ka qenë...

Anita Susuri: Luftën e Parë apo?

Naime Maçastena Sherifi: Luftën e Parë Botërore. Edhe përshkrun ni tmerr, ni tmerr që kanë përjetu për mënyren qysh janë depërtu, për mënyrën qysh janë vendosë atje, varfëni të cilën kanë përjetu, puna e randë që osht’ dashtë me bo. Pastaj, këto komunitete ni kohë të gjatë atje kanë mbetë pa integru, domethonë ende, domethonë te familja e dajve të mi kur unë kom shku në Bafër si fëmi që e mbaj mend herën e fundit që më kujtohet, ata kanë folë gjithmonë shqip. Domethonë, mrena atij komuniteti, mrena atij fshati, krejt kanë folë shqip mes veti edhe dasmat i kanë bo shqip edhe... këta ma ka thanë edhe baba jem, domethonë që e kanë rujtë shumë traditën.

Këto komunitete që kanë qenë në zona jo urbane, sepse ata që janë vendosë në zona urbane ma shpejt janë asimilu se osht’ dashtë m’u integru. Deshtën s’deshtën ata osht’ dashtë me shku nëpër shkolla, me hi nëpër puna, me msu turqishten, me ditë mirë turqishten, m’u integru me shoqërinë atje. Domethonë edhe kjo ka kontribu pak ma shumë në asimilim, sesa këta që kanë qenë të vendosun në zona rurale.

Anita Susuri: E prej cilit vend janë largu ata, të Kosovës?

Naime Maçastena Sherifi: Familja e nanës tem janë diku prej ni fshati Jashanicë të Klinës, mes Pejës edhe Klinës. Domethonë, të asaj pjese kanë qenë. Ndërkaq familja e babës janë me prejardhje prej Llapit, por shumë moti të ramë në Prishtinë, domethonë të ardhun në Prishtinë.

Anita Susuri: E pastaj ata janë kthy ni pjesë e familjes të nanës?

Naime Maçastena Sherifi: Jo, jo, jo. Ata s'janë kthy kurrë.

Anita Susuri: Ata kanë qëndru atje...

Naime Maçastena Sherifi: Ata atje jonë. Domethonë krejt janë atje, përveç nanës tem që osht' martu edhe osht' kthy me babën tem, të tjetër krejt janë atje, krejt janë atje. Përkundër asaj që daj të e mi, tezë e mia, krejt kanë lindë në Turqi ata shqip flasin. Domethonë, na komunikojmë shqip me ta. Fëmijë e tyre gjithmonë shqip kanë folë mes veti me fëmijë e vet.

Anita Susuri: Domethonë, baba ju j kur osht' transferu...

Naime Maçastena Sherifi: Baba jem osht' transferu '56-tën.

Anita Susuri: Janë njoftu atje domethonë?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita Susuri: E prej cilit domethonë, prej Prishtinës.

Naime Maçastena Sherifi: Prej Prishtinës.

Anita Susuri: Tash po më intereson edhe qikjo pjesë, në kohën e Rankoviqit i kanë detyru me dhunë apo kanë shku me...

Naime Maçastena Sherifi: Jo, i kanë detyru, i kanë detyru. Unë kom bisedu ma shumë edhe me babën tem këtë pjesë, edhe me gjyshin se deri vonë e kom pasë. Domethonë, masi më ka vdekë baba, bile më ka ra goxha gjatë me nejtë me gjyshin, se gjyshin e kom pasë imam, domethonë ka qenë hoxhë. Edhe ai masi vdiq baba erdh nejtë ni kohë me neve, se edhe ai ka qenë në Turqi, atje ka ndrru jetë. E me to kom bisedu pastaj ma edhe ma shumë në detale për këto. Edhe më ka tregu qysh e kanë marrë në pyetje, qysh e kanë keqtrajtu fizikisht, qysh e kanë majtë në kaca të ujit deri në mëngjes derisa ju ka ngri uji në oborr. Thotë, "Edhe kur shkojsha në shpi", thotë, "krejt me tesha të ngrime, me rroba të ngrime". Thotë, "Ma", tha, "e pashë që thjeshtë ose dojnë me më mbytë ose duna me vendosë m'u largu". Edhe i kanë detyru me i shitë pasuninë.

Këta ia kanë shitë shtetit pasuninë edhe me ato pare kanë mrri m'i ble vetëm biletat e trenit edhe ato vesikat, si lloj viza garancioneve që osht' dashtë m'i pagu atëherë edhe me qato. Thotë, "Krejt çka kemi marrë", thotë, "kanë qenë teshat e trupit, 400 kilogram libra", gjyshi jem që i ka pasë, 400 kilogram libra të veta i ka pasën, "ato" thotë, "i kom marrë me veti edhe rrobat e trupit. Tjetër çka s'kemi mujtë, gjithçka kemi lanë", thotë, "na ka marrë...", ni pjesë të pasurisë e kanë konfisku kur janë ekzekutu axhallarët e babës, i kanë marrë, se kemi pasë edhe vneshta, kemi pasë edhe shpi, kemi pasë goxha

vend. Ato si familje nacionaliste-balliste ua kanë konfisku edhe janë detyru pastaj krejt përniherë me dalë.

Anita Susuri: Domethonë e kanë pasë edhe presionin për shkak të axhallarëve?

Naime Maçastena Sherifi: Po, po.

Anita susuri: Në rregull, zonja Naime, faleminderit shumë. Nëse doni edhe diçka me shtu ose nëse mendoni që keni harru diçka...

Naime Maçastena Sherifi: Po besoj që krejt i thashë, nuk e di (qeshë).

Anita Susuri: Atëherë, faleminderit shumë!

Naime Maçastena Sherifi: Me nder qofsh!